



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 7957 Prot

Datë 10/05 2022

URDHËR

Nr. 349 Datë 10.05 2022

**“PËR LIRIM , SEKUESTRIMIN DHE HEQJEN E OBJEKTEVE QË ZËNE
HAPËSIRËN PUBLIKE NË AMBJENTE TË GJELBËRTA, TROTUARE DHE RRUGË
NË QYTETIN E SHKODRËS ”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 e ligjit nr.139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë Bashkiake dhe të Komunës” i ndryshuar; ligji nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar ;VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar;VKM nr.1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”,

URDHËROJ :

1. Lirimin ,sekuestrimit dhe heqjen e objekteve që zëne hapësirën publike ; karrige,tavolina, kjoska,kone,gure, kone betoni,tabela, goma makinash të vjetra,mjete që nuk lëvizin,rrethime, zgara,tenda për projektorët,çadra,reklama të vendosur në mënyrë abuzive tek shtyllat e ndriçimit publik,tabelat e qarkullimit rrugor si dhe çdo send tjetër që pengon qarkullimin e lire të njerëzve dhe mjeteve në lulishte, trotuare dhe rrugë, sipas planit dhe përgjegjësisë të detajuar në planin e punës sipas Aneksit A ‘Plan pune për lirimin , sekuestrimit dhe heqjen e objekteve që zënë hapësirën publike’ bashkëlidhur këtij urdhëri.

2.Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen:

- zv/kryetari i Bashkisë Shkodër z.Ardit Qylybyli
- Drejtoria e Shërbimeve Publike Investimeve dhe Infrastrukturës
- Policia Bashkiake
- Inspektoret e rajoneve 1, 2, 3,4,5

3.Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
BARDH SPAHIA

